

**AKT – THEMELIMI
(KONTRATË)
I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË
KUFIZUAR**

“ Autotransport On Time ” SH.P.K

Ne:

Unë, Dardan Sadiku , e dtl. 26/02/1994, lindur në Ferizaj, Kosovë dhe banues në Ferizaj, rruga Sali Çeku, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr.176545, dhe ID1614975, dhe nr personal 1170848906 e vlefshme deri më : 17/03/2030.

si dhe

Unë, Armend Qamili , e dtl. 28/01/1998, lindur në Prishtinë, Kosovë dhe banues në Ferizaj, rruga Halil Buqinca, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr.140427, dhe ID1476918, dhe nr personal 1172489580 e vlefshme deri më :24/09/2029.

kemi vendosur:

Neni 1

Të themelojmë një shoqëri tregtare me përgjigjisi të kufizuar për të ushtruar veprimtarinë ekonomike e emërtuar **“ Autotransport On Time ” SH.P.K** me ortakë:

- 1- Unë, Dardan Sadiku, e dtl. 26/02/1994, lindur në Ferizaj, Kosovë dhe banues në Ferizaj, rruga Sali Çeku, me dokument identifikimi Nr.176545, dhe ID1614975, dhe nr personal 1170848906 e vlefshme deri më :17/03/2030.
- 2- Unë, Armend Qamili , e dtl. 28/01/1998, lindur në Prishtinë, Kosovë dhe banues në Ferizaj, rruga Halil Buqinca, me dokument identifikimi Nr.140427, dhe ID1476918, dhe nr personal 1172489580 e vlefshme deri më :24/09/2029.

Neni 2

Shoqëria do të jetë e formës së Shoqërive tregtare me përgjigjisi të kufizuar dhe përballon humbjet deri në kufirin e vlerës të derdhur në kapitalin themelor.

Neni 3

Shoqëria e ka selinë e saj në Shkodër, Lagjja Bahcallek, Rruga Evlia Çelebiu, Nr Pasurie 2/1324-88, Zona Kadastrale 8591, ndertese 1-kateshe, Nr 56 . Shoqëria ka të drejtë të krijojë dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, filial, përfaqësi, degë,si dhe t'i suprimojë ato.

Neni 4

Shoqëria do të ketë një kohëzgjatje me kufi të pacaktuar e mbi 10 vjet. Ajo mund të shpërbëhet në çdo kohë me vendim të ortakëve.



Neni 5

Kapitali fillestar themelor i Shoqërisë do të jetë 100.000 lekë (njëqindmijë, i ndarë në 1 kuotë për secilin.

Dardan Sadiku , e dtl. 26/02/1994, lindur në Ferizaj, Kosovë dhe banues në Ferizaj, rruga Sali Çeku, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr.176545, dhe ID1614975, dhe nr personal 1170848906 e vlefshme deri më 17/03/2030 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe në përputhje me të.

Armend Qamili , e dtl. 28/01/1998, lindur në Prishtinë, Kosovë dhe banues në Ferizaj, rruga Halil Buqinca, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, me dokument identifikimi Nr.140427, dhe ID1476918, dhe nr personal 1172489580 zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 50% te kapitalit, vendosi të themelojë një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe në përputhje me të.

Kapitali themeltar është shlyer plotësisht në para nga Ortakët me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

Neni 6

Në librin e llogarisë që do të krijohet në Shoqërinë Tregtare do të shënohet dhe kapitali i derdhur nga ortakët. Rritja e kapitalit të ortakut nuk është e kufizuar.

Neni 7

Të gjitha pjesët e kapitalit themelor do të shlyhen në llogarinë e subjektit sapo të rregjistrohet dhe të hapet nr i llogarisë në një bankë të nivelit të dytë në teritorin e republikës së Shqipërisë.

Neni 8

Objekti i aktivitetit ekonomik do të jetë:



Transport ndërkombëtar i mjeteve motorrike, autovetura, furgona, kamiona, motorra, mjete lundrimi të ndryshme.

Transportin e mallrave dhe të udhetarëve për vete dhe të tretë, me mjetet e shoqërisë ose të të tretëve, brënda dhe jashtë vendit. Transport dhe tregtimin me shumicë dhe pakicë, import- eksport të mallrave të të gjitha llojeve, si industriale, ushqimore, bujqësore, blegtorale, elektroshtepiake, konfeksione, tekstile, kinkaleri, cigare, kimikate, prodhime qelqi, porcelani, plastike, lekure, lëndë të konservuara, pije freskuese, lende dhe materiale ndertimi, elektrike, elektronike, pllaka, materiale hidrosanitare, prodhime druri, duralumini, makinerive të të gjitha llojeve dhe pjeseve te kembimit, automjete të të gjitha tonazheve, parfumerisë, kancelarisë, detergjenteve. Transport me mjete frigoriferike.

Neni 9

Marrëdhëniet e punësimit në shoqëri do të rregullohen nëpërmjet kontratës së punësimit, që lidhet midis palëve në mbështetje të ligjit Nr. 7961, datë 12.07.1995 (Kodit të Punës), si dhe akteve të tjera nënligjore të dala në zbatim të tij.

Neni 10



Ortakët nuk kufizohen në rritjen e kapitalit të shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria vepron në rregjimin e pronës dhe merr përsiper të drejta e detyrime vetëm brenda kufirit të kapitalit të saj. Ortakët themelues mbartin rrezikun e veprimtarisë së Shoqërisë në nivelin e kapitalit të investuar në Shoqëri.

Neni 12

Mosmarrveshjet që mund të lindin gjatë ushtrimit të veprimtarisë private të shoqërisë midis ortakëve dhe në mes të Shoqërisë dhe punonjësve brenda saj, si dhe me të tretët, kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim, çështja mbetet në kompetencë të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Neni 13

Shoqëria do të ketë vulën e saj ku janë percaktuar dhe inicialet e emertimit të saj.

Neni 14

Organet e shoqërisë "**Autotransport On Time**" SH.P.K janë :

Ortakët e shoqërisë.

Administratori i shoqërisë.

Modalitetet e formimit dhe funksionimit të tyre do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

Administrator i shoqërisë do të jetë z. Dardan Sadiku , e dtl. 26/02/1994, lindur në Ferizaj, Kosovë dhe banues në Ferizaj, rruga Sali Çeku, me dokument identifikimi Nr.176545, dhe ID1614975, dhe nr personal 1170848906 e vlefshme deri më :17/03/2030.

Administratori caktohet për një afat 5-vjeçar.

Modalitete për ndryshimin e administratorit si dhe kompetencat e tij rregullohen nga statuti i shoqërisë, ligji 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" si dhe statuti i shoqërisë, ligji Nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"

Ky akt – Themelim është përpiluar në katër kopje me vlerë të njëjtë me origjinalin.

Datë, 13.09.2022

THEMELUESIT :

Dardan Sadiku

Armend Qamili

